



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Naim Pira, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamenti Ligjor dhe i Monitorimit të Komunave/ MAPL	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	<i>BF. Z. [Signature]</i>
Nga:	Venera Çerkini, U.D. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	<i>[Signature]</i>
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Vitisë	Date: 04/02/2018 020-657/3
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.01-410/03-539, të datës 05.06.2018, për formimin e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
E miratuar më datë më datë: 31.01.2019
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.02.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës ***është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi*** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Sokol Haliti, gradonačelnik Opštine Vitina Naim Pira, predsedavajući Skupštine opštine Vitina	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština-MALS	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u.	
Od:	Venera Çerkini, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum, 04.02.2019.
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Vitina	Br.020-657/3
Vrsta akta:	Odluka	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine, na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primio je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku.

Odluka o dopuni i izmeni Odluke br.01-410/03-539, od dana, 05.06.2018. godine, za formiranje Komisije za izbor predsednika sela, maseljenih mesta i urbanih naselja
Usvojena dana, 31.01.2019. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 04.02.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u saglasnosti odredbama zakonodavstva na snazi, i kao takav može proizvesti prvni efekat.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi osa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

01-02-2019
01-410/03-91

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008), neni 4 i rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vitisë Nr.01-013/858, të datës 17.07.2012, neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 31.01.2019, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-410/03-539, të datës 05.06.2018, për formimin e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi Komunal i Vitisë bënë ndryshim plotësimin e vendimit nr.01-410/03-539, të datës 05.06.2018, për formimin e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Neni 2

Konfirmo neni 1 të këtij vendimi, komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, duhet të ndryshohet dhe të plotësohet, ku neni 1 i vendimit nr. 01-410/03-539, të datës 05.06.2018, ku anëtari me numër rendor 4, z. Taulant Sefëdini zëvendësohet me z. Tetik Salihu.

Neni 3

Të gjitha pjesët tjera të vendimi nr.01-410/03-539, të datës 05.06.2018, për formimin e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane mbesin në fuqi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, anëtarët e komisionit dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 5

Ky vendim lypet në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrative të akteve të komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyres së Kryetarit,
2. Anëtarëve të komisionit,
3. Shërbimit të Kuvendit, dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Naum Pira
[Signature]



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKI I KOSOVËS
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pragje: 05-06-2018			
Nr. i Organi Org. broj	Numri/Broj	Sh. i Kodit Sh. i Kodit	Vlera Vendimor
01-410/03-539			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008), neni 4 i rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vitisë Nr.01-013/858 të datës 17.07.2012, neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.05.2018, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin Komisioni për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Komisioni përbëhet prej 5 anëtarë, dy anëtar nga kuvendi, një anëtar nga ekzekutivi, një anëtar nga Shoqëria civile dhe një anëtar nga përfaqësuesit e fshatit apo lagjes urbane:

1. Basri Sylejmani, anëtar i Kuvendit
2. Avdi Rexhepi, anëtar i Kuvendit
3. Fatlum Demiri, anëtar nga ekzekutivi komunal
4. Taulant Sefedini, anëtar nga shoqëria civile
5. Një anëtar nga përfaqësuesit e fshatit, lagjeve urbane

Neni 2

Komisioni sipas nevojës do të udhëheq dhe do të koordinojë punën në terren për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, sipas kriterëve dhe procedurave të parapara me rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vitisë, Nr.01-013/858 të datës 17.07.2012.

Neni 3

Komisioni obligohet që të udhëheqë të gjitha procedurat e parapara me nenin 2 të këtij vendimi për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Neni 4

Komisionit i pushon mandati pas përfundimit të procesit zgjedhor të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, anëtarët e komisionit dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrative të akteve të komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit,
2. Anëtarëve të komisionit
3. Shërbimit të Kuvendit, dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Naim Pira